



Pranimi / Dorëzuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery		20.04.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHK	1908/2021		115	



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.213/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Hysni Mustafa-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1766/19 të datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.261/2019, të datës 30.04.2019, të ankueses me adresë banimi Qyteza Pejton, Rr. Perandori Justinian Nr.124, nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Komisioni i Pavarur për Media, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në pajtim me Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 20.04.2021, mori këtë

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** ankesa A.nr.261/2019, e datës 30.04.2019, e parashtuar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi** Vendimi Nr.1904/513/KZKA/n.i. i datës 10.04.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komisionit të Pavarur për Media.

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur për Media, me datën 23.01.2019, ka pranuar autorizimin për shpalljen e konkursit për pozitën “Udhëheqës i divizionit të Monitorimit dhe Analizave të Operatoreve të Shpërndarjes (OSH) dhe OSHMA me Transmetim përmes OSH”, në Komisionin e Pavarur për Media, nga Ministria e Administratës Publike/ Departamenti për Shërbimin Civil.

Komisioni i Pavarur për Media, me datë 29.01.2019, ka shpallur konkursin për pozitën “Udhëheqës i divizionit të Monitorimit dhe Analizave të Operatoreve të Shpërndarjes (OSH) dhe OSHMA me Transmetim përmes OSH në Komisionin për Media”.

Komisioni i Pavarur për Media, me datë 21.02.2019, ka bërë njoftimin për kandidatin e suksesshëm për pozitën “Udhëheqës i divizionit të Monitorimit dhe Analizave të Operatoreve të Shpërndarjes (OSH) dhe OSHMA me Transmetim përmes OSH”.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 21.02.2019 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidati, për pozitën “Udhëheqës i divizionit të Monitorimit dhe Analizave të Operatoreve të Shpërndarjes (OSH) dhe OSHMA me Transmetim përmes OSH”, me datë 15.03.2019, me numër protokoll 1903/376/ADM/na me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek Komisioni i Pavarur për Media.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, me datë 10.04.2019, me numër reference 1904/513KZKA/n.i. ka nxjerr vendim me të cilën e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar në ligj.

Ankuesja e pakënaqur me vendimin me Nr.1904/513KZKA/n.i, të datës 10.04.2019, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, brenda afatit ligjor në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-048, për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.04.2019, ka parashtuar ankesë, me numër protokoll 2093/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se procedurat e rekrutimit dhe avancimi në karrierë është bërë në kundërshtim me kushtet e parapara të pjesëmarrjes në rekrutim për pozitën “Udhëheqës i divizionit të Monitorimit dhe Analizave të Operatoreve të Shpërndarjes (OSH) dhe OSHMA me Transmetim përmes OSH” në Komisionin e Pavarur për Media, dhe se zhvillimi i procedurës së rekrutimit për pozitën e lartcekur është bërë në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 02.05.2019, me numër protokoll 2123/2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Udhëheqësi i Personelit në Komisionin e Pavarur për Media, ndërsa me datën 13.05.2019 me numër protokoll 2261/2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komisioni i Pavarur për Media, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 261/2019, e datës 30.04.2019, me numër protokoll 2093/2019, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shpallje për Rekrutim të Brendshëm të datës 29.01.2019; Ankesë lidhur me procedurën e rekrutimit 15.03.2019; Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e datës 10.04.2019; Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 18.09.2018; Vendimin i KPM-së V2-2012; Kërkesa për punësim e kandidates së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Emali zyrtar i datës 26.03.2019; Emali zyrtar i datës 04.06.2014; Emali zyrtar i datës 03.06.2014; Emali zyrtar i datës 02.06.2015; Emali zyrtar i datës 01.06.2015; Emali zyrtar i datës 27.06.2014; Kërkesë për përgjigje e datës 02.05.2019; Përgjigja në anekse me numër 2261/2019 e datës 13.05.2019; Vendimi për Themelimin e Komisionit për Zgjedhjen e kontesteve dhe Ankesave i datës 01.03.2019; Njoftim për kandidatin e suksesshëm i datës 21.02.2019; Emali zyrtar i datës 29.01.2019; Emali zyrtar i datës 11.04.2019; Emali zyrtar i datës 26.03.2019; Emali zyrtar i datës 25.03.2019; Njoftim i datës 26.02.2019; Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 20.02.2019; Renditja përfundimtare e kandidateve; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Lista e pjesëmarrësve në intervistën me gojë e datës 19.02.2019; Emali zyrtar i datës 14.02.2019; Raport mbi përgatitjen e rezultatit të testit me shkrim; Lista e pjesëmarrësve në testin me shkrim e datës 12.02.2019; Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë e datës 08.02.2019; Raport mbi përgatitjen e listës së ngushtë e datës 07.02.2019; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Vendim i datës 06.02.2019; Emali zyrtar i datës 30.01.2019; Autorizim i datës 23.01.2019; Kërkesa për fillimin e rekrutimit 09.01.2019; Emali zyrtar 21.02.2019; Testi me shkrim; Kërkesa për punësim e kandidates së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aktgjykimin A.nr.1766/19 i datës 01.04.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se kriteret e konkursit të datës 29.01.2019 të shpallur nga Komisioni i Pavarur për Media, për pozitën “Udhëheqës i divizionit të Monitorimit dhe Analizave të Operatoreve të Shpërndarjes (OSH) dhe OSHMA me Transmetim përmes OSH”, kanë qenë:

Diplome Universitare në fushën e Gazetarisë/Komunikim Masiv, Filologjisë, Ekonomik, Shkenca Shoqërore, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Drejtësi;

Pesë (5) vite përvojë pune profesionale të përafërt me natyrën e punës së KPM-së, përvojë pune në institucionet publike ose në ndonjë organizatë ndërkombëtare, me theks në fushën e komunikimit masiv dhe të kulturës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që kandidatja e përzgjedhur nuk plotëson kushtet e konkursit pasi nuk ka shkollim adekuat dhe nuk ka përvojë punë relevante në menaxhim, konstaton që Departamenti për Administrimit e Shërbimit Civil i Ministrisë së Administratës Publike më datë 20.06.2019 ka miratuar kërkesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme ku ka përcaktuar kriteret që duhet përcaktuar në konkurs, kështu që Ministria e Punëve të Brendshme në konkursin e datës 21.06.2019 për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Kontratave”, ka përcaktuar kriteret si: *“Diplome Universitare në fushën e Gazetarisë/Komunikim Masiv, Filologjisë, Ekonomik, Shkenca Shoqërore, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Drejtësi; Pesë (5) vite përvojë pune profesionale të përafërt me natyrën e punës së KPM-së, përvojë pune në institucionet publike ose në ndonjë organizatë ndërkombëtare, me theks në fushën e komunikimit masiv dhe të kulturës.”*, rrjedhimisht në bazë të këtyre kriterëve Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka përgatitur listën e shkurtër ku në të janë përfshirë ankuesja dhe kandidatja Çavdarbasha si kandidate të suksesshme, e cila në bazë të dokumentacionit posedon Diplomën me nr. 3037 të datës 16.01.2014, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti Filozofik, me të cilin dëshmohet se me datë 04.05.2007 ka mbaruar studimet themelore në Departamentin e Etnologjisë dhe mori titullin Bachelori i Etnologjisë, si dhe në bazë të Vendimit Nr.053/19, të datës 15.01.2019, të lëshuar nga Kolegji AAB, me të cilin dëshmohet se me datë 15.01.2019 ka mbrojtur me sukses temën e masterit dhe ka fituar titullin Master në Komunikim Masiv dhe Gazetari, në bazë të akt emërimit të datës 01.10.2007 ka punuar në pozitën “Zyrtare e Lartë për Monitorim Regjional”, në Komisionin e Pavarur për Media, në këtë rast Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të këtyre provave të lëndës, ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur ka plotësuar kushtet e përcaktuar në konkurs, kështu që me rastin e përfshirjes së saj në listë të shkurtër është vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 28 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional dhe përvoja e punës”*, kështu që ky pretendim i ankueses është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që publikimi i shpalljes së rekrutimit të brendshëm është bërë në kundërshtim me nenin 17 të Rregullores Nr.02/2010, pasi që shpallja nuk është publikuar në shtypin ditor, faqen e portalit qeveritar dhe nuk është publikuar përmes mjeteve të informimit, konstaton se rekrutimi i brendshëm për pozitën “Udhëheqës i divizionit të Monitorimit dhe Analizave të Operatoreve të

Shpërndarjes (OSH) dhe OSHMA me Transmetim përmes OSH”, në Komisionin e Pavarur për Media, është shpallur duke u bazuar në Rregulloren Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil dhe në Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, rrjedhimisht nga kjo që u tha më lartë, Komisionin e Pavarur për Media ka hapur konkurs të brendshëm për avancim në karrierë e që Kolegji konstaton se KPM ka vepruar në pajtim me nenin 5 të Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil e cila përcakton se: **“Neni 5 Shpallja për avancim 1. Shpallja për avancim bëhet nga njësia e personelit brenda institucionit përkatës në vendet e përshtatshme ku kanë qasje të gjithë nëpunësit civilë. 2. Shpallja e avancimit fillimisht bëhet brenda njësisë së institucionit. 3. Nëse në pozitën e lirë aplikojnë më pak se tre kandidatë të cilët i plotësojnë kriteret sipas kësaj Rregulloreje, njësia e personelit shpall konkurs në nivel institucioni. 4. Shpallja duhet të jetë e hapur së paku 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit. 5. Shpallja duhet të përmbaj: Emrin e institucionit, emrin e njësisë organizative, titullin e vendit të punës, kategorinë funksionale dhe gradën e pozitës, vendndodhjen e pozitës, përmbledhjen e shkurtër të përshkrimit të punës, kriteret e vendit të punës, vendin ku mund të merren kërkesat për aplikim (shtojca I)”**, kështu që ky pretendim i ankueses është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që publikimi i shpalljes së rezultateve të rekrutimit është bërë në kundërshtim me nenin 41 pika 2 e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, pasi që nuk ka përmbajtur emrat, por vetëm një emër e kandidatëve të suksesshëm, konstaton se Komisionin e Pavarur për Media, konkursin e datës 29.01.2019, e ka shpallur vetëm për një pozitë, e që është pozita “Udhëheqës i divizionit të Monitorimit dhe Analizave të Operatoreve të Shpërndarjes (OSH) dhe OSHMA me Transmetim përmes OSH në Komisionin për Media”, rrjedhimisht nga kjo Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka vepruar në pajtim me nenin 41 paragrafin 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili përcakton se: **“Institucioni përkatës është përgjegjës për shpalljen e rezultateve të procedurës së rekrutimit në faqe të internetit të institucionit. Njoftimi përmban emrat e kandidatëve të suksesshëm, vendin e punësimit dhe pikët e fituara gjatë procedurës së përzgjedhjes”**, rrjedhimisht nga kjo konkursi i lartcekur është hapur vetëm për një vend pune dhe se në fund të procedurës së rekrutimit është shpallur vetëm një kandidat i suksesshëm, kështu që ky pretendim i ankueses është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që përzgjedhja e kandidatës së suksesshme të rekomanduar është bërë në kundërshtim me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, testi me shkrim i kandidatës së përzgjedhur të rekomanduar nga Komisioni Përzgjedhës ka qenë 100% i plotësuar, kjo vërehet tek citimi i nenit pikë për pikë gjë që len për të dyshuar se kandidatja e ka pasur testin me shkrim paraprakisht, si dhe ka pasur manipulim gjatë vlerësimit dhe poenimit të kandidatës së përzgjedhur e cila është favorizuar, Kolegji konstaton se ankuesja nuk ka arritur që ta dëshmojë me asnjë fakt pretendimin e lartcekur dhe se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, kështu që ky pretendim i ankueses është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komisionit të Pavarur për Media, me nxjerrjen e Vendimit Nr.1904/513/KZKA/n.i të datës 10.04.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me ankesën e ankueses

për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën “Udhëheqës i divizionit të Monitorimit dhe Analizave të Operatoreve të Shpërndarjes (OSH) dhe OSHMA me Transmetim përmes OSH”.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe bazuar në Aktgjykimin A.nr.1766/19 të datës 04.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.213/2021.

Hysni MUSTAFA


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses,
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Gjyqtarit Hajriz Hoti
- Kryeshefin Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media;
- Udhëheqësit të Personelit në Komisionin e Pavarur për Media dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

